



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 29. 01. 2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Shqyrtimi i Projektligjit “Për ratifikimin letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 40/2012”.
3. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11063, datë 19.1.2019 “Për propozimin e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Vullnet Sinaj, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi.

Të ftuar:

Dorina Çinari – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë
Agim Bregasi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Fatos Bundo - Drejtor (KESH)
Bahri Shaqiri – Kandidat i propozuar nga Presidenti
Bledar Dervishaj - Këshilltar për çështjet ligjor

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëdita!

Hapet mbledhja e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbalit. Ka ndonjë koment për procesverbalin? Nuk ka. Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 40/2012”. Relatore për këtë projektligj është zonja Evis Kushi.

Pika e tretë e rendit të ditës është shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr.11063, datë 19. 01. 2019 “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Për të diskutuar për pikën 2 të rendit të ditës kemi të pranishëm në mbledhje nga Ministria e Infrastrukturës zonjën Dorina Çinari, zëvendësministre, Agim Bregasi, drejtor, dhe Fatos Bundo, drejtor në KESH.

Fjalën e ka relatorja, zonja Evis Kushi!

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Ky projektligj propozohet nga Këshilli i Ministrave në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, Rregulloren e Kuvendit dhe me ligjin “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni ynë e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”. Ky projekt ka tri objektiva kryesorë.

Së pari, mbrojtjen e digave në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat.

Së dyti, rritjen e efikasitetit operacional të këtyre digave.

Së treti, qëndrueshmërinë në furnizimin me energji elektrike të këtyre digave në rajon.

Në thelb, kjo letërmarrëveshje nuk e ndryshon thelbin e marrëveshjes ekzistuese dhe as shumën e financimit, pra shuma e huas mbetet po e njëjtë, që është diku te 15,5 milionë euro, por ka dy qëllime.

Së pari, gjatë demontimit të turbinave janë vënë re disa probleme dhe për këtë arsye është e nevojshme të bëhen disa punime shtesë, të cilat sjellin nevojën e alokimit të një fondi prej

421 mijë eurosh nga kategoria e katërt, që është fondi i pakushtëzuar, në kategorinë e parë, që është ai për mallra dhe shërbime.

Dua të theksoj që ky parashikim ishte i pamundur të bëhej që në fillim, sepse vetë procesi i punës është i tillë, që vetëm gjatë demontimit dalin probleme dhe atëherë duket sa është thellësia e problematikës që duhet të ndiqet.

Objektivi i dytë ka të bëjë me shtyrjen e afatit. Për shkak se këto punime shtesë janë të nevojshme, afati i mbylljes së punimeve shtyhet nga qershori i vitit 2019 në dhjetor të vitit 2020.

Këto janë dy qëllimet kryesore. Më pas ka disa probleme të vogla për sa i takon teknikës legislative, që kur të vijmë nën për nën besoj se do t'i trajtojmë. Por në thelb dua të theksoj për kolegët e komisionit se projektligji është nismë pozitive dhe është e dobishme, ndaj u sugjeroj të gjithëve ta votojnë atë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër, shumë shpejt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duroni, zoti Bushati!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ndonjë pyetje? Po, zoti Haxhinasto.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A keni pyetje?

Edmond Haxhinasto – Po.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Për sigurinë e digave e kemi.

Edmond Haxhinasto – Patjetër, do t'i përmbahem çështjes.

Meqenëse nuk del qartë nga materiali, është grant apo kredi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është kredi.

Besoj me terma të butë të bankës zhvillimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Çfarë termash, zonja Zëvendësministre?

Dorina Çinari – Termat nuk i kemi këtu, por janë të vitit 2012.

Arben Ahmetaj – Po, por cilët?

Dorina Çinari – Në 0,25%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Fatos, thuaja termat zëvendësministres: 0,25%, sa është *fee*-ja, sa vite është? Sepse bëri pyetje zoti Haxhinasto.

Fatos Bundo – *Fee*-ja, sipas parashikimit, është 37 mijë euro e 500, që është paguar që në momentin kur kredia është bërë efektive. Ndërsa përqindja është mjaft e ulët, 0,25%, që është pothuajse një kredi me terma shumë të butë, për të cilët ne kemi rënë dakord që në vitin 2012.

Edmond Haxhinasto – Faleminderit!

Pyetja ime e dytë është: çfarë sfide ka për momentin menaxhimi i kaskadës së lumenjve Drin dhe Mat, në kuptimin e monitorimit të tyre? A keni një projekt, që përmirëson monitorimin e kaskadës *per se*, me qëllim që të rritet siguria energjetike e gjeneruar nga këto kaskada?

Arben Ahmetaj – Po, zonja Zëvendësministre.

Dorina Çinari – Projekti i sigurisë së digave është shumë i madh, i cili ka nisur në vitin 2008. Projekti ka komponentë kryesorë nga ana teknike...

Edmond Haxhinasto – Më falni që ndërhyj, por nuk po pyes për projektin..!

Dorina Çinari – Do të përgjigjem edhe për pyetjen tuaj.

Edmond Haxhinasto – Po pyes për menaxhimin e digave, pavarësisht se është jashtë projektit, duke përfshirë edhe projektin: çfarë sfide ka sot menaxhimi i kaskadës? Projekti është njëri element.

Dorina Çinari – Nga ana operacionale-teknike?

Edmond Haxhinasto – Në aspektin e menaxhimit të kaskadës.

Duhet të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Prisni, Fatos, se po flet zotëria!

Edmond Haxhinasto – ...bëhen investime të tjera strategjike, në kuptimin e vendosjes së ndërtimit të hidrocentraleve të tjera, siç është Skavica, apo thjesht në kuptimin menaxherial duhen përmirësuar protokollet e të tjerë? Pra, a keni sfida në axhendën tuaj për sa i takon menaxhimit të këtyre kaskadave, apo jeni në optimumin e mundshëm të menaxhimit të tyre? Kjo është pyetja, pra pavarësisht nga projekti.

Arben Ahmetaj – Po, zonja zëvendësministre.

Dorina Çinari – Do të përgjigjet zoti Agim Bregasi, që është ekspert i digave.

Arben Ahmetaj – Zoti Bregasi do të përgjigjet për monitorimin?

Dorina Çinari – Në lidhje me sfidat e kaskadës së Drinit.

Agim Bregasi – Siç dihet, herë pas here ka pasur sfida në kaskadën e Drinit, që nga ndërtimi i hidrocentralit të Vaut të Dejës në vitin 1970, atij të Fierzës në vitin 1978 dhe Komanit

në vitin 1986, natyrisht kanë pasur problemet e tyre, qoftë në vetvete si hidrocentrale, qoftë në kompleksitetin e tyre në menaxhimin e kaskadës nga pikëpamja hidrologjike.

Sikurse dihet, ne kemi një rregullore për menaxhimin e plotave në kaskadën e Drinit, e cila zbatohet me fanatizëm. Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ka një komision, që merret me menaxhimin e kaskadës pasi relatohet nga KESH-i dhe pranë KESH-it ka një sekretariat teknik kur ka probleme emergjente. Kjo është për sa i përket pikëpamjes hidrologjike. Ndërsa nga pikëpamja teknike e përditshme, natyrisht që ka monitorim: ka një qendër dispeçeri qoftë OST-ja, qoftë KESH-i për monitorimin hap pas hapi në kohë reale të çdo problemi, si, për shembull: sa janë prurjet, sa janë kuotat, si është bashkëveprimi ndërmjet hidrocentraleve, sa është prodhimi, ulja e kuotave e të tjerë.

Për sa i përket së ardhmes, natyrisht ka mbetur pa u shfrytëzuar pjesa e Drinit të Zi, ku janë parashikuar edhe ndërtimet e dy hidrocentraleve të tjera, ai i Skavicës dhe i Katundit të Ri, për të cilët po bëhen studime dhe së shpejti do të kemi një opinion se si mund të ndërtohet ose si mund të veprohet me ta.

Në përgjigje direkte, mund të themi se ka një monitorim të plotë të kaskadës së Drinit, duke i ndërlidhur të tre hidrocentralet, sepse varen nga njëri-tjetri nga pikëpamja hidrologjike, por edhe për çdo hidrocentral më vete.

Natyrisht, me përfundimin e studimit, edhe për hidrocentralin e Skavicës do të ndërmerren hapat konkretë, sepse me ndërtimin e Skavicës apo të një hidrocentrali tjetër duhet të ndryshojë edhe rregullorja e menaxhimit të plotave në kaskadën e Drinit.

Dua të bëj edhe një sqarim. Çdo hidrocentral, që tashmë ndërtohet me digë, ka një rregullore të miratuar nga Komiteti Kombëtar i Digave. Këtu mund të përmendim edhe rastin e hidrocentralit mbi lumin Devoll. Aktualisht, ka një rregullore për hidrocentralin e Banjës, si dhe i është vënë detyrë kompanisë “Statkraft” për të hartuar një rregullore komplekse duke marrë parasysh që pas disa muajsh do të vihet në shfrytëzim edhe hidrocentrali i Moglicës, që është në një rezervuar më të madh.

Mendoj se të gjitha këto veprime, menaxhime dhe observime janë në përputhje të plotë me ligjin “Për digat” dhe me rregulloret përkatëse të menaxhimit të prurjeve në këto lumenj.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto – A mendoni se kjo do të jetë kredia e fundit për të optimizuar menaxhimin e kaskadës? A mundet që kaskada të futet në qëndrueshmëri ose në *sustainability*, siç i thonë të huajt?

Agim Bregasi – Po.

Në vitin 2008, sikurse u përmend, është bërë një studim tërësor për të gjithë kaskadën e Drinit dhe në atë që u quajt “Projekti i rritjes së sigurisë së digave” dhe, natyrisht, që u parashikua një financim mjaft i madh. Deri tani janë aktivizuar rreth 86 milionë euro të marra nga Banka Botërore, BERZH-i, KfW-ja dhe një financim prej 6,4 milionë frangash zvicerane nga SECO, por në mirëmbajtjen e të gjithë kaskadës, në përmirësimin e punës së saj dhe në optimizimin e saj dhe të masave mbrojtëse për kaskadën ka kontribuar edhe vetë KESH-i me financimet e tij.

Natyrisht, ky nuk është fundi. Para periudhës shtator-tetor ju kaluat një financim tjetër për portat e Fierzës, të Komanit dhe Vaut të Dejës, por natyrisht hidrocentralet janë në dinamikë të përditshme.

Për të arritur...

Arben Ahmetaj – Zoti Agim, a mund t’i përgjigjeni direkt pyetjes: a është kredia e fundit? Mos na tregoni të gjithë historikun e digave.

Agim Bregasi – Këtë po thosha.

Arben Ahmetaj – A ka ndër mend qeveria të kontraktojë kredi për ndonjë projekt tjetër për Skavicën, për kaskadën, për monitorimin, për monetizimin? Kjo ishte pyetja.

Agim Bregasi – Këtë po thosha.

Pra, për të pasur një monitorim sipas parametrave të digave më të mira për rastet ose praktikatat më të mira, natyrisht nuk mbaron këtu, sepse më e mira është...

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Pra, përgjigjja është se kredia në fjalë nuk është e fundit, madje është normale që të mos jetë e fundit. Nuk ka nevojë për historikun.

Në qoftë se, zoti Haxhinasto, i mbaruat pyetjet, kam edhe unë disa për zëvendësministren: Si është situata e kaskadës në nivele hidrike? Çfarë risku paraqet dhe si është situata e importeve dhe eksporteve?

Dorina Çinari – Situata...

Arben Ahmetaj – Sa është sot kaskada e Drinit që nga...?

Dorina Çinari – Niveli i rezervuarëve sot është 263 metra/kub.

Arben Ahmetaj – I cilit rezervuar, se janë tre?

Dorina Çinari – Rezervuari kryesor i Fierzës.

Arben Ahmetaj – Po niveli i dy të tjerëve?

Dorina Çinari – Më falni, nuk i kam shifrat në këtë moment! Nuk isha përgatitur për këtë pyetje.

Arben Ahmetaj – Nuk ka gjë. Mendova se i dinit, ngaqë janë të dhëna operationale të përditshme apo edhe ngaqë merreni me energjinë. Në qoftë se mund të na ndihmojë një nga specialistët...

Po, Fatos.

Fatos Bundo – Siç e tha edhe zonja zëvendësministre, ne kemi probleme vetëm në Fierzë, për shkak të nivelit të ulët, ndërsa...

Arben Ahmetaj – Sa është niveli?

Fatos Bundo – 263 metra/kub, çka do të thotë se jemi rreth 30 metra nën kuotën maksimale.

Arben Ahmetaj – E qartë.

Fatos Bundo – Për sa i përket liqenit të Vaut të Dejës dhe Komanit, historikisht ato janë stabël, sepse...

Arben Ahmetaj – E qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatos Bundo – ...nga rrjetet anësore nuk kemi asnjëlloj problem. Pra, janë në kapacitet të plotë.

Arben Ahmetaj – Po niveli i importit sa është sot?

Fatos Bundo – Këto komandohen nga kërkesa që bën OSHEE-ja.

Arben Ahmetaj – Si është situata sot?

Fatos Bundo – Kam bindjen se është stabël, sepse edhe gjenerimi i të ardhurave që ka krijuar KESH-i vitin e kaluar...

Arben Ahmetaj – Pra, nuk po importoni, nuk po eksportoni...

Fatos Bundo – Jo, nuk bëhet fare fjalë.

Arben Ahmetaj – Jeni i sigurt për këtë?

Fatos Bundo – Jemi të sigurt.

Arben Ahmetaj – Pra, është vetëm furnizimi i prodhimit vendas.

Fatos Bundo – Sepse diferenca ndërmjet kërkesës së OSHEE-së është realizuar...

Arben Ahmetaj – E kam të qartë.

Fatos Bundo – ... është shumë e vogël dhe përballohet nga HEC-et e vegjël.

Arben Ahmetaj – Po HEC-et e vegjël sa po furnizojnë?

Fatos Bundo – Ato kompensojnë rreth 300...

Arben Ahmetaj – Sa po furnizojnë?

Fatos Bundo – Nuk e kam këtë informacion sot.

Arben Ahmetaj – Po çmimi që furnizojnë e keni sa është mesatarisht?

Dorina Çinari – Çmimi i HEC-eve të vegjël është i rregulluar.

Arben Ahmetaj – Sa është sot?

Dorina Çinari – Është tarifë vjetore.

Arben Ahmetaj – Është i rregulluar me bursën e Hungarisë.

Dorina Çinari – Jo, çmimi i HEC-eve të vegjël është tarifë vjetore, që miratohet nga ERE një herë në vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Sa ishte?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ju dëgjoj.

Dorina Çinari – Nuk e kam këtë të dhënë sot.

Arben Ahmetaj – Në rregull. Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një pyetje: a mendoni se financimi prej 15500 eurosh do të zgjidhë problemet dhe problematikat e konstatuara në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat, në mënyrë të tillë që të sjellë qëndrueshmëri në furnizimin me energji elektrike?

Faleminderit!

Agim Bregasi – Sikurse e thamë, kjo është një pjesë e kredive që ka marrë KESH-i, nëpërmjet qeverisë shqiptare, prej 86 milionë eurosh. Kjo është e destinuar, sikurse thuhet...

(Diskutime në sallë)

Arben Ahmetaj – Më falni, ta dëgjojmë pak drejtorin?

Ju lutem, zoti Bushati, ta dëgjojmë drejtorin!

Agim Bregasi – Sikurse thuhet edhe në relacion, tavani për rehabilitimin e hidrocentralit të Komanit ka qenë 15,5 milionë euro, madje edhe rialokimi që bëjmë është vetëm kalimi, siç u shpjegua, nga një zë te zëri i investimeve kapitale. Për centralin brenda ky është i mjaftueshëm.

Pastaj, sikurse e thashë, në tetor u miratua një fond prej 12 milionë eurosh, marrë nga BERZH-i, për të ndërhyrë në portat e të tre hidrocentraleve, Vaut të Dejës, të Komanit dhe Fierzës. Pra, rialokimi që bëjmë shkon vetëm për Komanin dhe me këtë mbyllen të katër agregatet.

Arben Ahmetaj – Ka pyetje të tjera nga kolegët? Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Edhe unë kam një pyetje, që, në fakt, lidhej me atë, por nuk e mora përgjigjen. Sot në raportin e FMN-së ka dalë që një nga problemet, që mund të ketë ekonomia vitin e ardhshëm, mund të jetë edhe thatësira.

A mund të na jepni një përgjigje lidhur me këtë, sepse gjithnjë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si është gjendja sot dhe si parashikohet pak a shumë, që të mos jemi të varur thjesht nga parashikimet? Kjo gjë shkruhet vit për vit, por a mund ta dimë me përafërsi? Faleminderit!

Agim Bregasi – Natyrisht, kuota 263 metra/kub nuk është më e mira e mundshme.

Ervin Bushati – Edhe një herë, se e thamë edhe këtë shifër, por 263 metra/kub nuk thonë asgjë për mua. Në qoftë se ma jepni me indeks ose në përqindje, mirë, se të më thoni 263, nuk e kam idenë fare, nuk e di sa është zakonisht në këtë kohë.

98% e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agim Bregasi – Jo, jo.

Ervin Bushati – Sa është zakonisht në këtë kohë? Atë “263-shin” e dëgjova, por për mua është një shifër kot.

Agim Bregasi – E qartë.

Ervin Bushati – Nuk e kam me ju, por thuhet gjithmonë kjo. Unë nuk e di sa është sot.

Agim Bregasi – Nuk ka gjë.

Sikurse e dini, ne kemi një sistem të bazuar tërësisht mbi hidrocentrale dhe e gjithë kuota, prodhimi, sjellja e sistemit varen nga reshjet.

Për fat, viti i kaluar nuk ishte shumë premtues, sidomos në pjesën e dytë të vitit, çka çoi edhe në konsumin e Fierzës për të plotësuar detyrimet që kishte ndaj OSHEE-së dhe kuota shkoi 263. Për të pasur një ide rreth kuotës normale, unë them se duhet të ishte diku mbi 280 e ca...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ose në fillim të vitit, ose sot duhet të ishte te 280-284 metra/kub.

Në fund të qershorit, pra kur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në ç’ kuptim, në përqindje?

(Deputeti Bushati ndërhyn pa mikrofon.)

Dorina Çinari – Të kujt?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Bushati – ...kjo është 80% e asaj që është normale.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë e di shumë mirë, sepse kam bërë aq fizikë, por ma thoni në përqindje, se shifrat “264” dhe “285” nuk më thonë asgjë.

Arben Ahmetaj – Në shtesë të zotit Bushati, unë ju pyeta: a ka import ose jo, ju m’u përgjigjët se jo, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, KESH-i, zoti Fatos, prodhon 10500, ia jep OSHEE-së, së cilës i duhen 45 mijë, çka do të thotë se sot, në janar, importi mbyllet me 45 milionë euro.

Prandaj, do t’ju lutesha, zoti Fatos, që kur vini të informoni komisionin, ndërkohë që është duke u importuar, të mos thoni se nuk është duke u importuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sistemi energjetik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju përfaqësoni sistemin energjetik, jo KESH-in.

Zëvendësministrja prezente është zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Muaji janar mbyllet me 45 milionë euro import, çka do të thotë se pyetja që bëri zoti Bushati i ka të dyja dimensionet, atë energjetik dhe atë fiskal, sepse thatësira godet buxhetin e shtetit. Kjo është edhe arsyeja pse zoti Bushati e bën atë pyetje dhe besoj se meriton përgjigje të detajuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agim Bregasi – Në fakt, sot dhe gjatë këtyre ditëve...

Arben Ahmetaj – Më falni, zoti Agim, si rregull, kërkohet leje për ta marrë fjalën në komision!

Megjithatë, meqenëse sot nuk i keni këto shifra operationale të përditshme, do t’ju lutesha, sekretaria ta mbajë shënim, të na jepni të paktën shifrat mujore. Madje do të sugjeroja që shifrat operationale të jenë sa më të përditësuara.

Faleminderit!

Dorina Çinari – Vetëm për sqarim, zoti kryetar, të dhënat operationale ju duhen për muajin e fundit apo për një periudhë?

Arben Ahmetaj – Ju na thoni atë që dini, nuk ka problem.

Dorina Çinari – Të dhënat janë, por shpeshësinë e informacionit në varësi të përvojës.

Arben Ahmetaj - Më thoni atë që dini dhe për periudhën që dini. Nuk ka problem. Mjafton të jeni e saktë në informacionin që ndani me komisionin.

Zonja zëvendësministre,

Keni përgjigje për pyetjen e zotit Bushati?

Dorina Çinari – Do të kemi nevojë të importojmë energji, nëse nuk ndryshon situata e reshjeve. Kemi borë në Veri. Bora nuk përkthehet automatikisht në ujë. Duhet të kemi një sezon të gjatë reshjesh shiu (jo bore), që të mund të prodhojmë energji vetë. Nuk jemi në kuotën më të mirë. Kuota minimale, pragu minimal është 244 metra. Ne nuk jemi në kuotën minimale, sepse jemi në 263 metra. Po prodhojmë energji, por jemi në kufijtë e nervozitetit të kaskadës. Do të kemi nevojë të blejmë, nëse nuk ndryshojnë reshjet. Kemi borë në Veri, por duhet të bjerë shi. Bora shkon në burimet nëntokësore dhe nuk përkthehet në ujë për kaskadën.

Arben Ahmetaj - Urdhëroni!

Ervin Bushati - Faleminderit!

Unë do të doja disa të dhëna që të tregonin pak a shumë, kapacitetin në sensin ekonomik. Bie apo nuk bie borë apo shi, kjo nuk do të thotë gjë për ne si ekonomistë. Në qoftë se thuhet se në një nivel indeksor kjo është në nivelin 80% të planifikimit, apo kapaciteti sot është 97%, kështu mund të fillojmë të mendojmë.

Pjesën se sa është niveli maksimal apo niveli minimal, ne nuk e dimë.

Hajde se po e plotpjesëtojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, sa ta mbaroj!

Të kemi një përqindje në volum të paktën dhe të na thuhet, se po vazhdoi kështu, do të blejmë energji. Këtë shkruan gjithmonë FMN-ja. Dihet që sistemi ynë, që bazohet nga sasia e reshjeve të shiut apo të borës, se kur bie shumë përmytet, kur bie pak është problem për energjinë. Ne mund ta duam diku në mes, por të paktën të dimë që ta parashikojmë, se këtë thotë gjithmonë FMN-ja. Varet sa thatësirë ka. Të paktën të dimë kapacitetin nëse jemi në 97% apo në 55%. Kjo ka diferencë të madhe. Nga shifrat për nivelet unë nuk marr vesh asnjë gjë, sepse edhe ju nuk e dini tamam volumin, apo jo? Duhet të bëjmë llogaritë dhe ato bëhen me përqindje, jo me metra. Ajo mund ta ketë bazën 100, por mund ta ketë edhe 5.

Arben Ahmetaj – Zoti Bushati, unë sugjeroj që t'i kërkojmë zëvendësministres të na sjellë në komision të gjithë planifikimin e prodhimit për vitin 2019, edhe planifikimin e importit, edhe fluktuacionet, sepse energjia është ciklike një herë në 4 vjet. Ka raste që 3 vjet janë me reshje dhe një vit mund të jetë i thatë, por ka raste, kur janë 2 me 2. Janë të përlllogaritura goditjet e mundshme në bilancin e sektorit, por edhe në buxhet.

Sot nuk i keni me vete të dhënat, por besoj se do të na i dërgoni sa të shkoni në zyrë, sepse unë jam i bindur që i keni atje. Kështu, pasdite ne do t'i marrim që të kemi edhe planifikimin. Besoj se ERE e ka bërë kolaudimin e planifikimit të prodhimit, qoftë nga KESH-i,

qoftë nga HEC-et private për importin e energjisë në pikën më të ulët të një viti të thatë, të një viti normal dhe të një viti të lagësht. Faleminderit!

Urdhëroni, zonjë!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Edhe unë bashkohem me kërkesën tuaj.

Nga ana tjetër, unë do të kërkoja të kishim një mbledhje të posaçme komisioni për pjesën e menaxhimit të sistemit të 3 kompanive në mënyrë që të kuptojmë reziqet që ka buxheti i shtetit për shkak të situatës meteorologjike, që sot nuk është e favorshme. Kjo ishte e para.

E dyta, duhet të thuhet edhe disa elemente të tjera, meqë sot u diskutua për menaxhimin e digave dhe situata atje është përmirësuar ndjeshëm nga ajo që ka qenë. Me këtë rast, prandaj duhet të flasim se si 3 kompanitë (ajo e prodhimit, e shpërndarjes dhe e transmetimit), me bilancet që kanë pasur në situatën në përmirësim të pjesës së prodhimit, apo të shpërndarjes së energjisë. Do të ishte mirë që ne të kishim një seancë në komision me përfaqësuesit 3 e kompanive së bashku me ministren përkatëse apo me zëvendësministrin, që mbulon sektorin, në mënyrë që të flasim pikërisht për risqet dhe për atë çfarë mund të presim për situatën energjetike në vend. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Besoj se zëvendësministrja e mbajti shënim kërkesën dhe sugjerimin e deputetes Gjylameti, për të bërë një seancë të plotë për të analizuar situatën në sektorin energjetik. Besoj se do ta planifikojmë së shpejti.

Para se të fillojmë votimin, nuk e di nëse edhe ju e thatë, por besoj se drafti ka nevojë për teknikë legjislative për të shënuar nenin 1, sepse është sjellë pa nen.

Në fund thuhet: ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Duhet thënë: ky ligj hyn në fuqi menjëherë. Besoj se i mbajtët shënim këto vërejtje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Për sa i takon teknikës legjislative, në projektligj duhen bërë disa ndryshime në projektligj.

Së pari, duhet të ndryshojë preambula, i gjithë paragrafi hyrës i projektligjit në këtë formë: “Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave...”.

Për sa i takon të gjithë tekstit të ligjit, që është i ndarë në dy paragrafë, paragrafi i parë të jetë neni 1 dhe paragrafi i dytë do të jetë neni 2 i projektligjit.

Siç e tha edhe kryetari në fund duhet të bëjmë edhe një ndryshim: fjala “vendim”, që duhet të zëvendësohet me fjalën “ligj”, sepse ky akt që po miratojmë sot, është ligj.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Atëherë, ju ftoj ta votojmë në parim projektligjin.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, ligji i dërgohet për shqyrtim seancës plenare me rregullimet që thamë.

Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Faleminderit, Elvi!

E votojmë edhe nen për nen projektligjin.

Neni 1 me ndryshimet e propozuara nga relatorja.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 me ndryshimet e propozuara nga relatorja.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit!

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi ky projektligj.

Faleminderit!

Dorina Çinari – Kryetar, nëse keni interes t’ju përcjellim të dhënat ciklike për sa i përket kaskadës dhe sistemit energjetik për një periudhë të caktuar kohe, ne jemi gati ta bëjmë. Kjo për njohurinë tuaj, për t’ju informuar në mënyrë ciklike derisa të kalojmë nga gjendja...

Arben Ahmetaj – Do të jetë shumë mirë t’i marrim sa më shpejt informacionet dhe në vazhdimësi.

Faleminderit!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.01.2019, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– Kryetar i komisionit

Rendi i ditës: Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11063, datë 19.1.2019
“Për propozimin e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Vullnet Sinaj, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi,

Të ftuar:

Bahri Shaqiri – Kandidat i propozuar nga Presidenti.

Bledar Dervishaj - Këshilltar për çështjet ligjore

Arben Ahmetaj – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, në shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11063, datë 19.1.2019 “Për propozimin e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga Presidenca kanë ardhur në komision zoti Bahri Shaqiri, kandidati i propozuar në dekret dhe zoti Bledar Dervishaj, këshilltar për çështjet ligjore.

Në bazë të procedurës, unë do të lexoj të gjithë përshkrimin e procedurës së ndjekur dhe të ngjarjeve të njëjta, të mëparshme dhe më pas, do të vazhdojmë me prezantimin e zotit Bahri Shaqiri.

Atëherë, bazuar në kalendarin e punimeve të Komisionit, sot në rendin e ditës kemi për shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11063, datë 19.1.2019 “Për propozimin e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i protokolluar në Kuvend me nr. 234, në datën 21.1.2019.

Dekreti propozon zgjedhjen e zotit Bahri Shaqiri për t'u zgjedhur kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky është dekreti i dytë që propozon për këtë pozicion kushtetues Presidenti i Republikës.

Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 126, datë 20.12.2018 rrëzoi kandidaturën e parë të propozuar nga Presidenti i Republikës, zonjën Vitore Tusha.

Siç dihet, vakanca e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit është krijuar më 15 dhjetor 2018, me përfundimin e mandatit të ish-kryetarit të KLSH-së, zotit Bujar Leskaj, të emëruar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 143, datë 15.12. 2011.

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së” parashikon qëndrimin në detyrë të kryetarit, që i ka mbaruar mandati deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, ndërkohë që në bazë të delegimit të njoftuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 8.1.2019, aktualisht funksionet e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit deri në emërimin nga Kuvendi të kryetarit të ri, i kryen drejtoresha e Përgjithshme e KLSH-së, zonja Lindita Milo.

Shqyrtimi parlamentar bazuar në Rregulloren e Kuvendit (neni 111 i saj):

Kryetari i Kuvendit ia ka kaluar menjëherë propozimin përmes dekretit të Presidentit të Republikës Komisionit për Ekonominë dhe Financat, i cili vendos nëse kandidatura i plotëson kushtet ligjore.

Bazuar në pikën 7, të nenit 111 të Rregullores thuhet: “Komisioni përgjegjës, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, shqyrton përmbushjen e kriterëve kushtetues e ligjore dhe meritën e çdo candidature. Komisioni organizon seancën dëgjimore publike me secilin kandidat.”

Kuvendi e shqyrton kërkesën në seancë plenare brenda 1 jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës. Kur asnjëra nga kandidaturat nuk merr shumicën e kërkuar të votave, procedura fillon me kandidatura të tjera nga e para, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.

Kushtet ligjore për t'u zgjedhur në pozicionin e kryetarit të KLSH-së, që përcakton neni 20 i ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së" janë:

"Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të zgjidhet shtetasi shqiptar, që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) ka arsim të lartë në ekonomi, financë ose drejtësi;
- b) përvojë profesionale në çështjet financiare;
- c) ka kualifikime të larta profesionale dhe përvojë pune në profesion jo më pak se 10 vjet;
- ç) gëzon integritet të lartë moral dhe profesional;
- d) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një krimi me vendim gjyqësor të formës së prerë."

Lexojmë edhe nenin 21 të këtij ligji, "Papajtueshmëritë e funksionit" dhe më pas, do të ftojme zotin Shaqiri të bëjë prezantimin e tij publik.

"1. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, nuk mund të jetë anëtar i Kuvendit, anëtar i Këshillit të Ministrave, i zgjedhur në organet e pushtetit vendor, apo në organet e ndonjë partie ose organizate politike.

Ai nuk mund të kryejë detyra me ose pa shpërblim në subjektet e tjera publike, private apo jofitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies, botimeve dhe veprimtarive kulturore e sportive, me kusht që këto aktivitete nuk dëmtojnë dinjitetin e institucionit dhe nuk cenojnë paanshmërinë dhe pavarësinë e tij.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit fillon detyrën pasi bën betimin përpara Kuvendit..."

Besoj se është momenti t'i jap fjalën zotit Shaqiri për të prezantuar CV-në e tij.

Urdhëroni, zoti Shaqiri!

Bahri Shaqiri - I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, anëtarë të Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

Fillimisht dua të vlerësoj angazhimin e këtij komisioni për të marrë në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11063, datë 19.1.2019 drejtuar Kuvendit për propozimin e kandidaturës sime për pozicionin e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Jam i nderuar nga ky vlerësim i lartë i kreut të shtetit, zotit Meta, i cili përmes kësaj përzgjedhjeje ka krijuar bindjen kushtetuese dhe besimin institucional se cilësitë dhe aftësitë e mia morale dhe profesionale, të dëshmuara gjatë përvojës 26-vjeçare, veçanërisht të atyre të niveleve më të larta drejtuese të institucioneve shtetërore shqiptare përputhen plotësisht me standardin dhe kriteret për zgjedhjen e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Besoj se të gjithë biem dakord, se standardet më të larta që duhet të karakterizojnë vizionin drejtues dhe punën e KLSH-së duhet të jenë: integriteti, pavarësia, profesionalizmi, transparenca dhe përgjegjshmëria.

Ky institucion me gjithë burimet ligjore, bazën ligjore dhe çdo element tjetër që e plotëson, nuk mund t'i shërbejë realizimit të këtij misioni, nëse nuk drejtohet nga një individ, që i mishëron këto cilësi. Pikërisht, këtë kod sjelljeje unë e kam dëshmuar nën drejtimin e institucioneve të tjera të larta të hierarkisë shtetërore. Jam përballur me sfida, të cilat i kanë sprovuar këto cilësi, duke qëndruar plotësisht dhe vetëm në shërbim të vendit me integritet, me përgjegjshmëri dhe duke ruajtur pavarësinë e plotë. Aftësitë e mia drejtuese janë testuar në çështjet më komplekse në luftën kundër kriminalitetit, përfshirë edhe atë ekonomiko-financiar dhe në menaxhimin e drejtpërdrejtë të burimeve financiare të hapura dhe atyre sekrete, duke e përmirësuar imazhin e institucionit ku kam shërbyer, në mbrojtje shumë të vendosur të interesave të vendit.

Detyrën e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për të cilën unë jam propozuar për t'u zgjedhur, e konsideroj si përgjegjësi shumë të madhe që përputhet plotësisht me profesionalizmin tim dhe me ambicien për të vazhduar të kontribuoj në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të këtij institucioni në dobi të vendit.

KLSH, si institucioni më i lartë i pavarur i auditimit të sektorit publik është një hallkë kyçe e sistemit të përgjegjësisë financiare të shtetit. Mbikëqyrja e shpenzimeve publike përmes auditit financiar, të përputhshmërisë dhe performancës me qëllim optimizmin e menaxhimit të parasë publike dhe parandalimit të korrupsionit dhe abuzimit me fondet publike përbëjnë misionin themelor të këtij institucioni.

Çdo përmirësim i menaxhimit dhe i veprimtarisë audituese të KLSH-së është drejtpërdrejt i lidhur edhe me rritjen e eficiencës së menaxhimit të financave publike.

KLSH është një institucion në ndihmë të vendit për të shpenzuar me mençuri dhe me efikasitet paratë publike. Për këto arsye reformimi dhe modernizimi i vazhdueshëm i KLSH-së, është një proces plotësisht i ndërlidhur me kuadrin e gjerë të reformave të ekzekutivit dhe të Kuvendit, veçanërisht me ato reforma që janë prioritare, të lidhura me përafrimin e standardeve tona me ato të BE-së.

Tashmë që Shqipëria është në pritje të çeljes së negociatave të anëtarësimit në BE, pjesë e këtij aksioni kombëtar reformash është padyshim edhe KLSH-ja. Si rrjedhojë, ndër objektivat parësore të këtij institucioni në periudhën në vijim do të jetë vendosja e një sinergjie politikash dhe veprimtarie me strukturat e tjera shtetërore, që veprojnë në fushën e auditimit, inspektimit financiar dhe në luftën kundër korrupsionit, duke iu përmbajtur gjithmonë parimit bazë të ruajtjes së pavarësisë së KLSH-së.

Kjo veprimtari do të jetë në përputhje me strategjinë e veprimtarisë së KLSH-së, si dhe me strategjitë e tjera të ndërlidhura në nivel kombëtar dhe sektorial.

Të nderuar deputetë,

Dua të theksoj se lufta kundër korrupsionit është një nga prioritetet kyçe, që BE-ja ka vendosur për Shqipërinë. Në raportin vjetor të përparimit të Shqipërisë, që është në proces hartimi, pjesë e rëndësishme e vlerësimit do të jenë padyshim, edhe rezultatet konkrete në këtë kuadër, ku përfshihet edhe puna e KLSH-së.

Zbatimi i plotë, i shpejtë dhe i qëndrueshëm i rekomandimeve të KE-së krahas rekomandimeve të EUROSAT-t do të jetë në vizionin tim edhe përparësi e përparësive të KLSH-së. Në kuadër, ndër institucionet më të rëndësishme në bashkëpunimin e domosdoshëm horizontal janë institucionet e drejtësisë dhe veçanërisht, ai i prokurorisë.

Është e rëndësishme të theksoj, se reforma e thellë së cilës po i nënshtrohet i gjithë sistemi ynë i drejtësisë, do të reflektohet padyshim edhe në rritjen e efikasitetit, bashkëpunimit dhe rezultateve të KLSH-së. Rritja e bashkëpunimit me partnerët do të jetë gjithashtu, një nga objektivat parësore të punës së KLSH-së, duke synuar jo vetëm përthithjen e modeleve më të mira dhe të suksesshme ndërkombëtare të auditimit, por edhe rritjen e nivelit të besueshmërisë dhe imazhit të KLSH-së te institucionet dhe agjencitë ndërkombëtare partnere. Thellimi i bashkëpunimit me INTOSAI-n dhe EUROSAT-in do të jetë prioritar.

Një tjetër objektiv i rëndësishëm i punës së KLSH-së, në vizionin tim, do të jetë rritja e transparencës me qëllim informimin në kohë reale dhe rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj institucionit të KLSH-së.

Synimi im është ndërtimi i një platforme komunikimi ku publiku duhet të perceptojë në çdo kohë se KLSH-ja është miku i qytetarëve, mbron interesat e tyre dhe pronën publike.

Të dhënat e KLSH-së, gjetje, raporte, rekomandime duhet të arrijnë te publiku në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë që ata të kuptojnë si ku dhe sa mirë po shpenzohen paratë publike që ato paguajnë nga taksat. Kjo do të nxisë një kulturë të re dhe të shëndetshme civile të ngjashme me vendet e tjera europiane që maturon demokracinë dhe institucionet shtetërore.

Rritja e transparencës do të jetë një instrument i dobishëm për nxitjen e përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së administrimit publik dhe kontribut për mirëqeverisje dhe luftën kundër korrupsionit. Përcaktimi i prioriteteve për fushat dhe strukturat më të ekspozuara ndaj fenomenit të korrupsionit me sensitivitet të lartë e që lidhet me përdorimin e parasë publike, si edhe përqendrimi i burimeve njerëzore më të kualifikuara në to do të fuqizojë rolin luftues dhe parandalues të korrupsionit të KLSH-së.

Të nderuar deputetë, vizioni im për përmirësimin e vazhdueshëm të punës së KLSH-së është edhe mbajtja e një lidhjeje të ngushtë bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet supreme të auditimit në nivel europian dhe global, INTOSAI; ndjekja me përparësi e dinamikës së zhvillimeve dhe standardeve të reja që vendosin këto organizma, si edhe përshtatja e këtyre standardeve me funksionimin e KLSH-së do të jenë fokusi im në drejtim të përmirësimit të punës së këtij institucioni.

Për realizimin e këtij objektivi vlerësoj se shtyllat kryesore ku do të mbështetet progresi i KLSH-së për periudhën në vijim do të jenë: përmirësimi i veprimtarisë audituese të KLSH-së, si edhe përmirësimi i veprimtarisë menaxheriale institucionale. Në këtë drejtim, si edhe në drejtim të përmbushjeve të detyrimeve kushtetuese, KLSH-ja do të vijojë praktikën pozitive të ushtrimit të auditimeve në fushën e përputhshmërisë, performancës, si edhe atë financiare. Auditimet e përputhshmërisë do të fokusohen në sektorët me rrezik të lartë për korrupsionet dhe mashtrimet financiare me orientim drejt përdoruesve më të mëdhenj të fondeve publike. Politikat e menaxhimit do të synojnë konsolidimin e kryerjes së këtij lloj auditimi në drejtim të konstatimit të shkeljeve të ligjshmërisë në menaxhimin e fondeve publike dhe nivelit të korrupsionit në vend. Identifikimi dhe adresimi i përgjegjësive dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës me synim mirëqeverisjen do të jetë një nga prioritetet e veprimtarisë audituese. Krahas disiplinës financiare, KLSH-ja do ta thellojë auditimin e performacës përmes matjes së treguesve të eficiencës, efikasitetit dhe rezultatit ekonomik të institucioneve shtetërore, objekte të këtij auditimi.

Evidentimi i auditit të performancës do të ketë ndikim edhe në një kuptim më të qartë dhe më të drejtpërdrejtë të publikut për shërbimet që marrin në këmbim të parave të shpenzuara dhe në tërësi për nivelin e mirëqeverisjes dhe përgjegjshmërisë publike në nivel qendror dhe lokal.

Unë besoj se përmirësimi i metodologjisë së kontrollit, i cilësisë së burimeve njerëzore dhe dhënia përparësi auditimit të performacës do të kontribuojnë në rritjen e profesionalizmit dhe rolit të KLSH-së.

Duke çmuar punën dhe kontributin e dhënë deri tani nga çdo punonjës i KLSH-së unë do të investohem për aftësimin edhe më cilësor të burimeve njerëzore të institucionit, trajnimin e vazhdueshëm të tyre, duke pasur si qëllim shndërrimin e një trupe model audituesish si në raport me detyrat dhe përgjegjësitë e punës, ashtu edhe në raport me partnerët, me institucionet supreme të auditimit europian dhe ndërkombëtar.

Në këtë drejtim do të bëhet e gjithë përpjekja për të realizuar bashkëpunim të frytshëm me institucionet vendase dhe ndërkombëtare me qëllim forcimin e kapaciteteve të ngritura tashmë në këtë institucion përmes vazhdimësisë qëndrueshmërisë, kualifikimit dhe integritetit të lartë moral dhe profesional; sigurimin e një stafi të qëndrueshëm të kualifikuar dhe me integritet të lartë moral dhe profesional, i aftë për të realizuar detyrat e ngarkuara; nxitjen e zhvillimit të kapaciteteve profesionale nëpërmjet aplikimit të metodologjive të reja novatore për stafin.

Busulla orientuese e veprimtarisë së institucionit do të jetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, kuadri ligjor që rregullon të gjithë fushën e veprimtarisë së KLSH-së, si dhe standardet më të mira europiane të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t. Zbatimi me rigorozitet dhe integritet i këtij kuadri tërësor janë garancia më e madhe e suksesit dhe pavarësisë së këtij institucioni. Gjithashtu, bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë dhe konsultimet e rregullta me Komisionin për Ekonominë dhe Financat, jo vetëm për informimin e rregullt si një detyrim kushtetues, por edhe në funksion të rolit mbikëqyrës që Kuvendi ka, do të jetë vlerë e shtuar në interesin më të mirë të publikut.

Së fundi, dua të vë në dukje se KLSH-ja ka rritur të renditet në institucionet më autoritare dhe më të vlerësuara shqiptare, kjo falë edhe kontributit të drejtuesve pararendës dhe trupës së specializuar dhe profesioniste të audituesve të ngritur prej vitesh.

Të nderuar deputetë, si vend kandidat për anëtarësimin në BE, Shqipëria është një vend ku mundësia për reforma të mëtejshme ka vetëm një limit, është standardi europian. Stafi profesionist i KLSH-së do të punojë çdo ditë vetëm me këtë objektiv, çka do të evidentohet edhe në raportet më të qarta të mirëargumentuara cilësore dhe josasiore me rekomandime dhe rezultate konkrete.

Unë garantoj se, në rast se zgjidhem nga Kuvendi në këtë detyrë të rëndësishme, do të bashkëpunoj ngushtësisht me komisionin tuaj dhe Kuvendin dhe bashkërisht do të punojmë me integritet, paanshmëri, profesionalizëm, pavarësi dhe përgjegjësi.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Do të vijojmë me pyetje dhe diskutime. CV-ja juaj është shumë e njohur.

Përparim Spahiu – A do të ndikojë reagimi i shpejtë i zotit Ulsi Manja në vendimmarrjen e Komisionit të Ekonomisë për kandidaturën, pasi menjëherë sapo Presidenti paraqiti emrin e zotit Shaqiri pranë Kuvendit për pozicionin e kryetarit të KLSH-së, ne patëm një reagim shumë të shpejtë të kryetarit të Komisionit të Ligjeve, zotit Manja.

Arben Ahmetaj – Ju lutem, a mund të ma thoni çfarë reagimi bëri zoti Manja?

Përparim Spahiu – Zoti Ulsi Manja reagoi vetëm gjysmë ore pas shpalljes së kandidaturës. Nëse ju nuk jeni i qartë, besoj se një nga anëtarët e Komisionit të Ekonomisë duhet ta dijë se zoti Manja shprehu kundërshti në lidhje me propozimin e Presidentit.

Arben Ahmetaj – Unë mendova se do t'i bënit pyetje zotit Shaqiri, megjithatë ne do të vazhdojmë procedurën sipas ligjit. Pra, nuk ka lidhje me deklaratimet e ndryshme përtej këtij komisioni. Ligji i jep këtij komisioni të drejtën, detyrën dhe përgjegjësinë për të gjykuar, kështu që ky komisionin do të gjykojë dhe do të vendosë, nuk ka lidhje me askënd jashtë këtij komisioni.

A ka pyetje të tjera?

Edmond Haxhinasto- Unë dua të shpreh vlerësimin tim për këtë kandidaturë. Unë mendoj se është një kandidaturë, e cila ka në vetvete një eksperiencë institucionale në nivelin më të lartë, ka të gjitha kualifikimet, siç i kërkon ligji dhe Kushtetuta. Figura e zotit Shaqiri është një figurë me integritet dhe besoj se këtyre cilësive dhe kësaj eksperience duhet t'i referohemi dhe, madje vetëm këtyre cilësive, duhet t'iu referohemi kur të japim vlerësimin sa i takon kësaj kandidature.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Faleminderit për prezantimin!

Besoj se, sipas procedurës, këtu mbaron dëgjesa juaj publike, më pas komisioni do të mbledhet për të marrë vendimin dhe për t'ia rekomanduar seancës.

Media, po të dojë, të dëgjojë vendimmarrjen, mund të qëndrojë. Do ta bëjmë publike. Media, 3 minuta pushim, për një rakordim të komisionit! Kuptohet ju bëni sikur nuk regjistroni, por, ndërkohë, regjistroni.

(Pas pushimit)

Arben Ahmetaj - ... procedurës. Dekreti ka disa ditë që ka ardhur. Ne kemi shqyrtuar me kujdes CV-në, plotësimin e kushteve dhe kemi përgatitur një draft-vendim për ta pranuar apo rrëzuar dekretin. Gjithashtu, bëmë një konsultë të fundit pasi dëgjuam të propozuarin.

Analiza paraprahe për përputhshmërinë e kriterëve ligjore.

Pas leximit të CV-së dhe dokumentacionit provues, rezulton se zoti Bahri Shaqiri ka përvojë pune mbi 10 vjet kryesisht në fushën e sigurisë kombëtare dhe atë të mbrojtjes (2002-2012) (ka qenë 10 vjet drejtues në Shërbimin Informativ Shtetëror), kurse 5 vjetët e fundit (2014-aktualisht), ka punuar në funksione politike në administratën e lartë publike, duke mbajtur pozicione të këshilltarit të ministrit, zëvendësministër dhe këshilltar i Presidentit.

Sa më sipër, në zbërthim të kriterëve formale ligjore, sipas nenit 20 të ligjit nr.154\2014, mund të konstatojmë se kandidati plotëson kriterin e arsimimit. Ka disa kualifikime për profesionin e ushtruar në fushën e sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Prezumohet se ka integritet moral dhe nuk ka dënime të formës së prerë me vendim gjykate për shkak të funksioneve të tij të larta në Shërbimin Informativ Shtetëror dhe më pas në administratën e lartë publike, si dhe detyrueshmërisë ligjore për t'u verifikuar në zbatim të ligjeve të posaçme, si ligji i dekriminalizimit dhe ai i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit. Në dokumentacionin e përcjellë kandidati ka plotësuar dy formularë, sipas kërkesave të ligjeve 138\2018 dhe 45\2015, por nuk dihet nëse këto deklarime i janë nënshtruar verifikimit të organeve përgjegjëse deri në kohën e përcjelljes së dekretit. Organi propozues është Presidenti i Republikës, i cili duhet të jetë edhe organi kërkues për verifikimin për arsye se kandidati i propozuar, për shkak të funksionit që mban në institucionin e Presidencës ka kaluar verifikimet ligjore.

Gjithsesi, në seancë Kuvendi mund të kërkojë informacione shtesë, por administrata nuk ka kërkuar. Nuk rezulton që gjatë gjithë karrierës së tij kandidati të ketë përvojë profesionale në fushën financiare dhe veçanërisht në çështjet e auditimit të jashtëm, sipas kuptimit të termit në ligjin nr.154\2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Pasja e certifikatës së audituesit publik nuk provon se kandidati e ka ushtruar këtë profesion dhe nuk mund të konsiderohet si eksperiencë në auditimin financiar në kuptimin e termit të ligjit nr. 154\2014.

Angazhimet e tjera profesionale të zotit Shaqiri janë të fokusuara në fushën e sigurisë, të cilat në çdo rast mund të vlerësohen maksimalisht në përputhje me kriteret e tjera, por jo me ato të parashikuara nga ligji për Kontrollin e Lartë të Shtetit. Siç është konsideruar edhe në raportet e mëparshme të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, për arsye të specifikës dhe unicitetit të funksioneve që kryen Kontrolli i Lartë i Shtetit, eksperiencia e posaçme në legjislacionin financiar dhe auditimin financiar është e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme nga eksperiencia të tjera.

Të gjitha eksperiencat e mëparshme të zotit Shaqiri janë larg specifikës së çështjeve financiare në përgjithësi dhe auditimit në veçanti, si veprimtaritë më të rëndësishme të Kontrollit

të Lartë të Shtetit, të tilla si auditimi financiar, auditimi i performancës, auditimi i përputhshmërisë, auditimi i rregullshmërisë dhe ai i IT-së.

Kështu që, duke iu referuar tagrit kushtetues të këtij komisioni, pasi të votojmë, ky komision do t'i dërgojë seancës vendimin e tij për mosmiratimin e kandidaturës së zotit Bahri Shaqiri për Kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, propozuar me dekretin nr.11063, datë 19. 01. 2019 të Presidentit të Republikës “Për propozimin e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Miratimi ose mosmiratimi vjen pas votimit që do të bëhet këtu. Drafti është mosmiratimi i kandidaturës së zotit Bahri Shaqiri.

Votojmë për rrëzimin e dekretit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Kush është pro dekretit të Presidentit? Kundër?

Atëherë, në bazë të kuorumit dhe tagrit që i jep ligji, komisioni rrëzon dekretin e Presidentit dhe i propozon seancës rrëzimin e dekretit të Presidentit.

Faleminderit!

Këtu mbyllet edhe takimi.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti

